

## KOMENTAR I FORMULARIT TË RAPORTIMIT TË NJËSIVE TË MBROJTJES SË FËMIJËVE/ PUNONJËSVE PËR MBROJTJEN E FËMIJËS

---

Bazuar në Ligjin Nr.18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”<sup>1</sup> dhe në aktet nënligjore, Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijës (NJMF/PMF) raportojnë pranë Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF) sipas periodicitetit të caktuar. ASHDMF është institucioni i cili ka përgjegjësi për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, si dhe monitorimin e zbatimit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri.

Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës në bashki ngrihet dhe funksionon si njësi e posaçme brenda strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel bashkie dhe ka për detyrë, në mënyrë të posaçme, parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijës në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje.

Raportimi periodik i NJMF/PMF-ve realizohet nga 2 formularë:

- **Formulari A** lidhet me kërkesën për raportim për të dhënat statistikore të rasteve të menaxhuara të fëmijëve;
- **Formulari B** lidhet me kërkesën për informacion përshkrues mbi rastet e reja dhe mënyrën e menaxhimit të tyre.

### **Formulari A (plotësohet në mënyrë periodike, çdo tre muaj dhe një herë në vit)**

**1-** Indikator Nr. 1 “**Numri i rasteve të menaxhuara në total**” duhet të plotësohet me numrin e rasteve në total të fëmijëve në rrezik të menaxhuar nga NJMF/PMF për periudhën raportuese. Totali i këtij numri është rezultat i numrit të rasteve të mbartura më parë, të cilat nuk janë mbyllur ende por menaxhohen dhe monitorohen në vazhdimësi, dhe i numrit të rasteve të reja për periudhën raportuese. Ky indikator përfaqëson numrin e dosjeve të fëmijëve në rrezik që NJMF/PMF ka aktualisht të hapura.

---

<sup>1</sup> Aktualisht, janë në rishikim aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji dhe detyrimi për raportim nga NJMF/PMF-ja do të rregullohet përmes këtyre akteve nënligjore.

**Shembull:**

<i>Bashkia/ Njësia administrative _____</i>	<i>Periudha raportuese</i>
<i>1. Numri i rasteve të menaxhuara në total</i>	<i>10</i>

2- Indikatori Nr. 2 “**Numri i Planeve Individuale të Mbrojtjes të hartuara nga NJMF/PMF**” duhet të plotësohet me numrin e planeve të hartuara nga NJMF/PMF-ja për fëmijët në nevojë për mbrojtje. Kjo është e dhënë vjetore dhe plotësohet në fund të vitit.

**Shembull:**

<i>Bashkia/ Njësia administrative _____</i>	<i>Periudha raportuese</i>
<i>2. Numri i Planeve Individuale të Mbrojtjes të hartuara nga NJMF/PMF-ja</i>	<i>3</i>

3- Indikatori Nr. 3 “**Numri i rasteve të reja**” duhet të plotësohet me numrin e rasteve e reja të cilat kanë filluar të menaxhohen nga NJMF/PMF-ja për periudhën raportuese. Këto raste duhet të specifikohen sipas gjashtë nën indikatorëve:

- grupmoshës      0-3 vjeç  
                          4-6 vjeç  
                          7-9 vjeç  
                          10-12 vjeç  
                          13-15 vjeç  
                          16-18 vjeç

*\*Totali i këtij nën indikator duhet të përputhet me numrin e rasteve të reja.*

- gjinisë            femra  
                          meshkuj

*\*Totali i këtij nën indikator duhet të përputhet me numrin e rasteve të reja.*

- etnisë             rom  
                          egjiptianë  
                          etni të tjera (Psh. Arumunë, Maqedonas, Malazez, Grek etj.)  
                          popullsi maxhoritare (janë gjithë të tjerët duke mos përfshirë etnitë  
                          e më sipërme)

*\*Totali i këtij nën indikator duhet të përputhet me numrin e rasteve të reja.*

**Shembull:**

<i>Bashkia/ Njësia administrative _____</i>	<i>Periudha raportuese</i>
<i>Numri i rasteve të reja</i>	<i>3</i>
<i>Rastet e reja specifikojini sipas:</i>	
• <i>Grupmoshës:</i> <i>0-3 vjeç</i>	<i>1</i>
<i>4-6 vjeç</i>	<i>1</i>
<i>7-9 vjeç</i>	<i>0</i>
<i>10-12 vjeç</i>	<i>0</i>
<i>13-15 vjeç</i>	<i>0</i>
<i>16-18 vjeç</i>	<i>1</i>
• <i>Gjinisë :</i> <i>Femra</i>	<i>2</i>
<i>Meshkuj</i>	<i>1</i>
• <i>Etnisë</i> <i>Rom</i>	<i>2</i>
<i>Egjiptian</i>	<i>0</i>
<i>Të tjerë</i>	<i>0</i>
<i>Popullsia maxhoritare (Shqiptare)</i>	<i>1</i>

4- Indikatori Nr. 4 “**Numri i rasteve të identifikuar/referuar nga:**” duhet të plotësohet me numrin e rasteve të fëmijëve sipas aktorëve që kanë bërë identifikimin dhe ja kanë referuar NJMF/PMF. Këto janë aktorët nga të cilët NJMF/PMF ka marrë sinjalizimin për fëmijën në rrezik. Zakonisht këto aktorë përfshijnë: NJMF/PMF vetë, policia, OJF, prindi, fëmija, institucionet arsimore, institucionet shëndetësore, administratori i NE. Nëse ka raste që janë referuar nga aktorë që nuk përfshihen në listë, ato duhen klasifikuar te opsioni “Tjetër”. Totali i këtij indikatori duhet të përputhet me numrin e rasteve të reja. **(Indikatori Nr. 3).**

**Shembull:**

<i>Bashkia/ Njësia administrative _____</i>	<i>Periudha raportuese</i>
<i>Numri i rasteve të fëmijëve të identifikuar/referuar nga:(referohuni Nr. të rasteve të reja)</i>	
• <i>NJMF/PMF</i>	<i>1</i>
• <i>Policia</i>	<i>1</i>
• <i>OJF</i>	<i>0</i>
• <i>Prindi</i>	<i>0</i>
• <i>Fëmija</i>	<i>0</i>
• <i>Institucione arsimore</i>	<i>1</i>
• <i>Institucione shëndetësore</i>	<i>0</i>
• <i>Administratori i NE</i>	<i>0</i>
• <i>Të tjerë (specifiko) _____</i>	<i>0</i>

5- Indikatori Nr. 5 “**Numri i rasteve të mbyllura**” duhet të plotësohet me numrin e rasteve të fëmijëve në rrezik që NJMF/PMF ka mbyllur gjatë periudhës raportuese. Totali i rasteve të mbyllura duhet të specifikohet sipas arsyes për mbylljen e rastit.<sup>2</sup>

- fëmija është mbi 18 vjeç;
- ndërhyrjet e ndërmarra e kanë reduktuar nivelin e rrezikut, në rrezik të ulët ose mungesë rreziku;
- fëmija nuk gjendet më në atë situatë dhe kur nuk paraqiten rrethana që fëmija të kthehet në atë situatë rreziku përpara se të mbushë 18 vjeç;
- fëmija vdes;
- fëmija transferohet në një zonë tjetër dhe rasti transferohet për ndjekje tek një NJMF/PMF tjetër.

**Shembull:**

<i>Bashkia/ Njësia administrative _____</i>	<i>Periudha raportuese</i>
<b>Numri rasteve të mbyllura</b>	<b>4</b>
<b>Rastet e mbyllura specifikojini sipas arsyes:</b>	
• <i>fëmija është mbi 18 vjeç</i>	<i>0</i>
• <i>është reduktuar niveli i rrezikut, në rrezik të ulët/mungesë rreziku</i>	<i>2</i>
• <i>fëmija jashtë rrezikut dhe nuk ka më gjasa të kthehet përpara se të mbushë 18 vjeç</i>	<i>1</i>
• <i>fëmija vdes</i>	<i>0</i>
• <i>fëmija është transferuar në një vendbanim tjetër</i>	<i>1</i>

6- Indikatori Nr. 6.a “**Numri i masave të mbrojtjes të marra me vendim të drejtorit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore të propozuara nga NJMF/PMF/drejtori i NJMF të specifikuar si më poshtë:**” - Ky indikator plotësohet me numrin e masave të mbrojtjes që ka aplikuar NJMF/PMF për fëmijët që janë në situatë të pasigurt për shkak të dhunës, abuzimit, neglizhimit apo shfrytëzimit sipas masave më poshtë bazuar në kreun IV të Ligjit Nr.18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”:

- *Masa emergjente e mbrojtjes, për largimin e fëmijës nga familja dhe vendosjen në përkujdesje alternative*
- *Masa e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative*
- *Masa e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar të fëmijës në mjedisin familjar*
- Indikatori Nr. 6.b “**Numri i masave të mbrojtjes të vendosura nga gjykata e rrethit gjyqësor të specifikuar si më poshtë:**”. - Ky indikator plotësohet me numrin e masave të mbrojtjes që janë validuar në gjykatë.
  - *Masa emergjente e mbrojtjes, për largimin e fëmijës nga familja dhe vendosjen në përkujdesje alternative*
  - *Masa e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative*

<sup>2</sup> Udhëzimi Nr. 10, datë 25.02.2015 “Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës”

**Shembull:**

<b>Bashkia/ Njësia administrative</b>	<b>Periudha raportuese</b>
<b>a) Numri i masave të mbrojtjes të marra me vendim të drejtorit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore të propozuara nga NJMF/PMF/drejtori i NJMF/PMF të specifikuar si më poshtë:</b>	<b>2</b>
• Masa emergjente e mbrojtjes, për largimin e fëmijës nga familja dhe vendosjen në përkujdesje alternative	<b>1</b>
• Masa e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative	<b>1</b>
• Masa e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar të fëmijës në mjedisin familjar	<b>0</b>
<b>b) Numri i masave të mbrojtjes të vendosura nga gjykata e rrethit gjyqësor të specifikuar si më poshtë:</b>	<b>1</b>
• Masa emergjente e mbrojtjes, për largimin e fëmijës nga familja dhe vendosjen në përkujdesje alternative	<b>1</b>
• Masa e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative	<b>0</b>

7- Indikatori Nr. 7 “**Numri i rasteve të menaxhuara sipas nivelit të rrezikut**” duhet plotësuar duke specifikuar numrin e rasteve të menaxhuara në total (**Indikatorit Nr.1**) për periudhën e raportimit sipas nivelit të rrezikut në të cilin është vlerësuar se ndodhet fëmija. Rreziku ndahet në katër nivele:<sup>3</sup>

**Rrezik i ulët** - fëmija është disi i sigurt dhe ka aftësi për të mbrojtur vetveten. Fëmija nuk është plagosur, ose është plagosur shumë lehtë në pjesë të trupit të cilat nuk prekin pjesët jetësore, si p.sh. gjunjët, duart etj. Plagosja mund të ketë ndodhur një herë të vetme dhe nuk ka pasur ndonjë ndikim të dukshëm te fëmija. Fëmija mund të ndjekë si zakonisht shkollën, dhe mezi pret të shkojë në shtëpi në fund të ditës. Prindi/Kujdestari ka gatishmërinë dhe kapacitetin të përkujdeset për fëmijën dhe dëshiron të mësojë praktika pozitive prindërimi.

**Rrezik i mesëm** - fëmija është i vogël, ka aftësi të kufizuara vetëmbrojtëse (për shembull mund të ketë një vonesë në zhvillim) ose mund të ketë nevojë për përkujdesjen e një të rrituri. Fëmija është plagosur pak (në zona të rëndësishme të trupit), dhe prindi/kujdestari njihet për ndëshkime dhe disiplinë strikte. Fëmija mbetet vazhdimisht mbrapa në mësim dhe mund të ketë vështirësi në sjellje. Prindi/Kujdestari kanë vështirësi për të kontrolluar sjelljen e tij (për shembull, për shkak të çrregullimeve emocionale), dhe mund të shfaqin pikëpamje dhe mendime të paqën-drueshme lidhur me dëshirën e tyre për të ndryshuar stilin e prindërimin.

<sup>3</sup> Udhëzimi Nr. 10, datë 25.02.2015 “Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës”

**Rrezik i lartë** - fëmija nuk është në gjendje të kujdeset për veten e tij, ose për arsye të ndryshme mund të ketë kapacitete të ulëta për t'u kujdesur për veten. Abuzuesi ka plagosur fëmijën në pjesë jetësore të trupit duke përfshirë kokën, qafën dhe organet riprodhuese. Sjellja e abuzuesit bën që fëmija të kërkojë rregullisht ndihmën mjekësore ose të kërkojë shtrimin në spital. Abuzuesi nuk ka dëshirë të ndryshojë stilin e tij/të saj edukativ që mund të ketë lidhje edhe me drogën, alkoolin ose sëmundje psikologjike dhe/ose nuk mund të garantojë që do të ketë ndryshim në sjelljen e tij/saj, pavarësisht premtimit për një ndryshim të tillë. Abuzuesi njihet si një person që dëmton fëmijën. Fëmija është i frikësuar nga prindi/kujdestari i tij dhe për këtë arsye mund të largohet nga shtëpia. Fëmija mund të ketë probleme serioze në sjellje, për shkak të arsyeve familjare, ose nuk mund të jetë në gjendje të ndjekë shkollën. Abuzuesi ka kontakt të rregullt me fëmijën dhe nuk ka persona të tjerë në familje të cilët mund të luajnë rolin e kujdestarit kryesor. Të gjitha abuzimet seksuale me kontakte fizike klasifikohen si raste me rrezik të lartë.

**Rast emergjent** - fëmijë në situatë emergjente konsiderohet, fëmija i cili nëse lihet në rrethanat aktuale, pa asnjë ndërhyrje mbrojtëse, mund të vdesë, të dëmtohet ose plagoset rëndë, apo të jetë pre e keqtrajtimeve të konsideruara vepër penale sipas Kodit Penal.

**Shembull:**

<i>Bashkia/ Njësia administrative</i>	<i>Periudha raportuese</i>
<i>Numri i rasteve të menaxhuara sipas nivelit të rrezikut: (referohuni Nr. të rasteve në total)</i>	<i>10</i>
• <i>i ulët</i>	<i>5</i>
• <i>i mesëm</i>	<i>3</i>
• <i>i lartë</i>	<i>2</i>
• <i>Emergjent</i>	<i>0</i>

8- Indikatori Nr. 8 “**Numri i vizitave të kryera në familje**” duhet të plotësohet me numrin e vizitave që ka kryer NJMF/PMF gjatë periudhës së raportimit me qëllim vlerësimin e fëmijës, familjes si dhe monitorimin e rasteve në ndjekje etj. Në këtë indikator nuk përfshihen vizitat që kryen administratori i NE, por përfshihen ato vizita që kryen NJMF/PMF-ja për menaxhimin e rasteve.

**Shembull:**

<i>Bashkia/ Njësia administrative</i>	<i>Periudha raportuese</i>
<i>Numri i rasteve të menaxhuara sipas nivelit të rrezikut: (referohuni Nr. të rasteve në total)</i>	<i>25</i>

9- Indikatori Nr. 9 “*Numri i rasteve të fëmijëve në ndjekje sipas problematikave*” duhet të plotësohet duke patur parasysh problematikën kryesore që paraqet rasti dhe që e vendos fëmijën në situatë rreziku, ose përbën faktor vulneribiliteti duke rritur mundësitë që fëmija të bëhet viktimë e abuzimit, shfrytëzimit, dhunës apo neglizhimit.

Problematikat më të hasura janë:

➤ **Dhunë në familje**<sup>4</sup> është çdo akt dhune i ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare dhe nënkupton cdo veprim apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër që sjell si pasojë cënim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik. Fëmijët mund të jenë viktima të dhunës në familje por dhuna mund të jetë dhe konteksti ku ndodhet fëmija.

➤ **Trafikim**<sup>5</sup> është çdo veprim ose transaksion, me anë të të cilit fëmija rekrutohet, transportohet, transferohet, fshihet ose merret me anë të kërcënimit apo përdorimit të forcës, apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike, nga një person a grup personash, me anë të shpërblimit ose me qëllim të përfitimit material apo çdo lloj fitimi tjetër, për qëllime të shfrytëzimit seksual, transferimin e organeve të një fëmije, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin si dhe formave të tjera të shfrytëzimit.

➤ **Shfrytëzim fëmije**<sup>6</sup> nënkupton kur njëra palë përfiton, ose financiarisht ose në çdo formë tjetër nga përdorimi i fëmijëve. Shfrytëzim fëmije përfshin, por nuk kufizohet vetëm në shfrytëzimin seksual, prostitucionin, punë ose shërbime të detyruara, skllavërimin ose praktika të ngjashme me skllavërimin, robërimin ose heqjen e organeve.

• Faktorët e mëposhtëm nuk përbëjnë dhunë në vetvete por janë faktorë vulneribiliteti të cilët mund të rrisin mundësinë që fëmija të bëhet viktimë e abuzimit, shfrytëzimit, dhunës apo neglizhimit:

➤ **Probleme ekonomike** lidhen me mungesën ose pamjaftueshmërinë për të siguruar minimumin jetik të individit ose familjes, kur këto të fundit nuk marrin gjithashtu shërbime apo mbështetje të mjaftueshme të formave të tjera nga strukturat shtetërore apo organizata humanitare.

➤ **Aftësi e kufizuar**<sup>7</sup> përfshin dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore të individit, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe

---

<sup>4</sup>Ligji Nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në mardheniet familjare”

<sup>5</sup> Udhëzimi Nr. 10, datë 25.02.2015 “Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës”

<sup>6</sup> Udhëzimi Nr. 10, datë 25.02.2015 “Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës”

<sup>7</sup> Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”

të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.

➤ **Mosregjistrim** i fëmijës në gjendjen civile e përjashton fëmijën nga të gjitha shërbimet si psh, kujdes shëndetësor, arsimim dhe shërbime të tjera.

➤ **Mosregjistrim në shkollë/ Braktisje shkollore** përfshin ato raste kur fëmija nuk është regjistruar në shkollë si edhe rastet kur fëmija braktis shkollën për shkak të gjendjes së vështirë socio-ekonomike, rezultateve të dobëta në mësim, konflikteve dhe mosmarrëveshje si me prindërit ashtu edhe me mësuesit, demotivimi për të shkuar në shkollë etj.

*Fëmija mund të ketë më tepër se një problematikë, kështu që NJMF/PMF-ja duhet ta klasifikojë sipas problematikës kryesore. Ky indikator duhet të plotësohet duke ju referuar numrit total të rasteve (Indikatorit Nr.1). Pra shumatorja e rasteve duhet të jetë njësoj me shifrën e totalit. Nëse rasti nuk është përfshirë në problematikë e sipërpërmenduar atëherë rasti duhet të klasifikohet në opsionin “Tjetër” dhe duhet të specifikohet problematika.*

**Shembull:**

<i>Bashkia/ Njësia administrative</i>	<i>Periudha raportuese</i>
<i>Numri i rasteve të fëmijëve në ndjekje sipas problematikave (referohuni Nr. të rasteve në total)</i>	
• <i>dhunë në familje</i>	<i>1</i>
• <i>trafikim</i>	<i>0</i>
• <i>shfrytëzim fëmije ( përfshihen fëmijët në situatë rruge dhe fëmijët që punojnë në format më të këqija të punës)</i>	<i>2</i>
• <i>probleme ekonomike</i>	<i>5</i>
• <i>aftësi e kufizuar</i>	<i>1</i>
• <i>mosregjistrim</i>	<i>1</i>
• <i>mosregjistrim në shkollë/ braktisje shkollore</i>	<i>0</i>
• <i>Tjetër (specifiko)</i>	<i>0</i>

10- Indikator Nr. 10 “*Numri i rasteve të fëmijëve në ndjekje sipas llojit të abuzimit*” duhet të plotësohet në ato raste kur fëmija mund të ketë përjetuar abuzim fizik, abuzim seksual, abuzim psikologjik, neglizhim, apo ndonjë formë tjetër abuzimi. “Abuzimi apo keqtrajtimi i fëmijëve përfshin të gjitha format e keqtrajtimit fizik dhe/ose emocional, abuzimin seksual, lënien pas dore apo trajtimin neglizhues, shfrytëzimin e fëmijes për qëllime përfitimi apo çdo lloj tjetër që shkakton dëmtim aktual apo të mundshëm të shëndetit, mbijetesës, zhvillimit apo dinjitetit në kontekstin e një marrëdhënie përgjegjësie, besimi apo pushteti.” (OBSH, 1999). Ky indikator përfshin katër lloj abuzimesh<sup>8</sup>:

*Abuzimi fizik përfshin çdo tentativë, dëmtim fizik apo plagosje e fëmijës, të cilat nuk janë aksidentale dhe që synojnë të shkaktojë dhimbje ose shqetësim, sado të lehta qofshin këto. Në abuzimin fizik përfshihen forma të tilla, si: rrahja, shkundja/shytyja me forcë, djegia, goditja (shuplakë ose shkelm), pickimi, çjerrja, kafshimi, qortimi i rreptë, detyrimi me forcë për të kryer një veprim, përdorimi i lëndëve që shkaktojnë dhimbje ose shqetësim.*

<sup>8</sup> Udhëzimi Nr. 10, datë 25.02.2015 “Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës”



**Abuzimi seksual** përfshin çdo veprim ose aktivitet seksual që kryhet për përfitim ose kënaqësi seksuale të abuzuesit – pavarësisht nëse fëmija pranon ose jo quhet abuzim seksual i fëmijës. Ky abuzim mund të jetë “me kontakt” siç është përdhunimi ose “pa kontakt” si për shembull detyrimi ose inkurajimi i një fëmije për të parë apo për të qenë pjesë e komunikimeve apo materialeve me përmbajtje pornografike.

**Abuzimi psikologjik** përfshin veprimet që shkaktojnë dëmtime të shëndetit fizik, mendor, moral dhe social të fëmijës dhe që, ndër të tjera, kanë sjellë si pasojë kufizimin e lirisë së lëvizjes, sjellje degraduese, kërcënuese, frikësuese, diskriminuese, përqeshëse ose forma të tjera të trajtimit armiqësor apo refuzues nga prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, përfaqësuesi ligjor, një i afërm i familjes ose çdo person tjetër që e ka për detyrë të kujdeset për fëmijën).

**Neglizhim** quhet mungesa kronike dhe serioze e kujdesit dhe vëmendjes, me ose pa qëllim, nga prindërit/kujdestarët ndaj nevojave të fëmijës për strehë, siguri, mbikëqyrje, ushqim, shëndet dhe arsim, që sjell dëmtim fizik dhe/apo emocional të fëmijës.

Fëmija mund të ketë më tepër se një abuzim, kështu që NJMF/PMF duhet ta klasifikojë sipas abuzimit kryesor që ka përjetuar fëmija. Ky indikator duhet të plotësohet duke ju referuar numrit total të rasteve (**Indikatorit Nr.1**).

**Shembull:**

<b>Bashkia/ Njësia administrative</b>	<b>Periudha raportuese</b>
<b>Numri i rasteve të fëmijëve në ndjekje sipas llojit të abuzimit</b>	
• abuzim fizik	0
• abuzim seksual	0
• abuzim psikologjik	1
• neglizhim	2
• Tjetër (specifiko) _____	0

## **Formuali B ( plotësohet çdo tre muaj në mënyrë periodike)**

Ky formular përmban informacion të përmbledhur për çdo rast të ri të menaxhuar nga NJMF/PMF-ja, trajnimet dhe aktivitetet ndërjegjësuere.

**1.** Përshkruani në mënyrë të përmbledhur mënyrën e menaxhimit për rastet të reja për tremujorin (të cilat janë të përfshira në indikatorin nr. 3, formulari A) duke u bazuar në

pikat: Problematika dhe lloji i abuzimit, kush e referoi/ identifikoi rastin, niveli i rrezikut, gjendja e fëmijës dhe familjes, vlerësimi fillestar, vlerësimi i thelluar, vizitat në familje, mbledhja e grupit teknik ndërsektorial, hartimi i planit të mbrojtjes, shërbimet e ofruara, monitorimi i rastit, masat e mbrojtjes.

2. Jepni informacion të përditësuar për rastet e mbartura të cilat nuk janë mbyllur ende por menaxhohen dhe monitorohen në vazhdimësi. Këto janë raste të raportuara më parë. Informacioni duhet të të përmbajnë veprimet e kryera në kuadër të: rivlerësimit të rastit, rishqyrtimit të planit të mbrojtjes, rishikimit të masës së mbrojtjes.

3. Përshkruani funksionimin e grupin teknik ndërsektorial:

- Mbledhjet e GTN, bëhen për vlerësimin e plotë, hartimin dhe miratimin e planit individual, si dhe rishikimin periodik të tij.
- Cilët kanë qenë aktorët pjesëmarrës (Psh; Përfaqësues i strukturës së Policisë, Përfaqësues i Shërbimit Social Rajonal, Përfaqësues i Drejtorisë Arsimore Rajonale, Administratori i NE, Edukatorja/ mësuesja, Psikologu i shkollës, Specialisti i shëndetit, Koordinator i çështjet e dhunës, OJF-të që ofrojnë shërbime për fëmijën, Zyra e punës, Përfaqësues nga gjykata, Përfaqësues nga prokuroria etj.)
- Cilët nga aktorët e ftuar në GTN nuk marrin pjesë.
- Cilët kanë qenë aktorët të cilët nuk marrin përgjegjësitë të përcaktuara nga GTN në kuadër të planit individual të mbrojtjes. Listoni të gjitha rastet konkretisht.
- Si ka qenë pjesëmarrja e fëmijëve apo prindërve në Grupi Teknik Ndërsektorial.

4. Listoni aktivitetet ndërgjegjëse të organizuar gjatë periudhës raportuese që përfshijnë aktorës pjesëmarrës, tematika dhe organizatorët.

5. Listoni trajnimet sipas tematikës dhe specifikoni se nga cilat institucione/ organizata kanë ofruar këto trajnime.

### **Të dhënat e NJMF/PMF-së duhet të plotësohen si më poshtë:**

- Personi i cili është caktuar zyrtarisht të kryejë detyrën e NJMF/PMF-së (emër dhe mbiemër)
- NJMF/PMF-ja duhet të përcaktojë nëse kryen funksione të tjera përveç punës si punonjës i mbrojtjes së fëmijëve.
- NJMF/PMF-ja duhet të përcaktojë nëse ka profil “Punonjës social”
- Kontaktet personale tel/ email të cilat do të përdoren për komunikim institucional
- Data e emërimit të NJMF/PMF duhet të jetë data kur punonjësi ka marrë detyrën si punonjës i mbrojtjes së fëmijëve.
- Drejtuesi i NJMF/PMF është personi i cili NJMF/PMF raporton në lidhje me punën e saj (emër dhe mbiemër)